



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:265725

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06280603

K.DH.SH.II.nr.1076/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija – Ymeri dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Biotek Kosovo” L.L.C, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Atdhe Dika, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Erlehëta Popaj dhe Neki Krasniqi si dhe të paditurit Spitali Regjional Prizren të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bejtullah Likaj, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1444/22 të datës 26.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Lego” ShPK me seli në Prishtinë, e datës 30.04.2024 ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1444/22 të datës 26.03.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e atakuar KA.nr.1444/22 të datës 26.03.2024, nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ka vendosur, Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Biotek Kosovo” L.L.C, Anulohet vendimi PSH.nr.344/17 i datës 31.10.2017 i nxjerr nga Organi Shqyrtues i Prokurimit. Nën pikën II. Obligohet i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit që paditësit “Biotek Kosovo” L.L.C

ti kthej tarifën ankimore në shumë prej 480€ (katërqind e tetëdhjetë euro) në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nën pikën III. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Biotek Kosovo” L.L.C, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri i dytë Spitali Regjional Prizren, që si pasoj e mos dhënies së kontratës në aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me aparat-analajzer biokimik automatik” me numër të prokurimit 70010-17-172-1-2-1 të iniciuar AK Spitali Regjional Prizren, t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar në formën e fitimit të humbur në shumë prej 16,817.80€ me kamatë vjetore prej 8% në vit duke filluar nga data 07.12.2017 e deri në përmbushjen përfundimtare. Nën pikën IV. Ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit së autorizuar, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar ose jo të plotë të së drejtës materiale. Me propozim që të Dhoma e Shkallës së Dytë pas shqyrtimit të pretendimeve sipas kësaj ankese, të njejtën ta aprovoj si të themeltë dhe pikën III. të dispozitivit të aktgjykimit KA.nr. 1444/22 ta ndryshoj ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesa ndaj të paditurës së dytë Spitali Regjional i Prizrenti duke e detyruar të njëjtin që t’ia kompensoj paditësit dëmin material në formën e fitimit të munguar në shumën prej 16,817.80€ me kamatë vjetore 8% në vit duke filluar nga data 07.12.2027.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Panelit Shqyrtues të Prokurimit Publik, PSH.nr.344/17 i datës 31.10.2017, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, refuzohet si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Biotek Kosovo”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me aparate analajzer biokimik-automatik”, me nr. prokurimi: “70010/17/172/121/04” iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/Spitali Regjional Prizren. Nën pikën II, vërtetohet, njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së/ Spitali Regjional Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me aparate analajzer biokimik-automatik”, me nr. prokurimi: “70010/17/172/121/04”. Nën pikën III, Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nën pikën IV. Mosrespektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Nën pikën V. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues “Biotek Kosovo” ShPK-Prishtinë refuzohet

si e pa bazuar i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 11.12.2017, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të pa bazuar duke vepruar si në dispozitiv të aktgjykimin. Me arsyetim se Gjykata bazuar në provat e administruara në procedurën administrative dhe provave të administruara gjatë procedurës së konfliktit administrativ, gjeti se i padituri i dytë me rastin e rivlerësimit të tenderëve dhe i padituri i parë me rastin e vendosjes sipas ankesës së paditësit, nuk ka vlerësuar drejtë përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit nga OE fitues, duke vepruar në kundërshtim me LPP nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore dhe nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike. Nga provat e administruara, respektivisht ekspertiza e prokurimit publik e hartuar nga eksperti N.F., gjykata gjeti se OE “Uni Care” ishte i papërgjegjshëm për faktin se nuk kishte ofertuar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. OE fitues nuk kishte dorëzuar autorizimin konform dosjes së tenderit, pasi që i njëjti nuk kishte qenë për shitje dhe servisim, nuk kishte dorëzuar certifikatën për servisim, nuk kishte ofertuar në përputhje me kërkesën për trajnim, nuk kishte pjesët shpenzuese dhe pjesët rezervë për së paku 5 vite si dhe nuk kishte ofruar deklaratën me ofertë e cila nuk ka numër protokolli dhe as titull të tenderit. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se i padituri i dytë me rastin e rivlerësimit të ofertave, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP, si dhe pikën 39 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP) i datës 01.11.2016 (i cili ka qenë në fuqi në kohën e zhvillimit të aktivitetit të prokurimit). Gjykata gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar gjeti se i padituri i dytë gabimisht kishte vlerësuar se OE fitues ka përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në dosjen e tenderit, pasi që gjykata nga provat e administruara vërtetoi se OE “Uni Care” kishte ofertuar me pajisjen analajzer në përputhje me specifikacionet e përcaktuara në dosjen e tenderit. Kjo pasi që gjykata duke iu referuar ekspertizës së ekspertit të biokimisë klinike, gjeti se OE “Uni Care” nuk kishte ofruar pajisjen e cila punon me parimin e spektrofotometrise dhe potenciometrise për mostrat biokimike dhe elektrolitëve, nuk funksionon me gjatësi valore gjatësitë min 340 deri 800 nm, nuk ka detektimin për koagulim të mostrës dhe përplasjes së gjilpërës, krivetat për lexim të jenë nga kuarci me kualitet të lartë si dhe nuk mundëson memorizimin e të dhënave të pacientëve në data bazë min. 100,000 mostra, me mundësi të transferimit të dhënave në CD ose në data bazë. Gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në përputhje me nenin 47 par. 1 nën par. 2 të LPPA-së dhe përfundimisht gjeti se Vendimi PSH.nr. 344/17 i datës 31.10.2017 duhet të anulohet pasi që i njëjti nuk është nxjerr në përputhje me dispozitat e LPPA-së të cilat përcaktojnë përmbajtjen e aktit administrativ, si dhe nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike siç u konstatua më lartë. Gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri i dytë që paditësit t’ia kompensojnë demin e shkaktuar në formën e fitimit të humbur si pasojë e mos dhënies së kontratës në aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me aparat –

analajzer biokimik automatik” me numër të prokurimit 70010-17-172-1-2-1 të iniciuar AK Spitali Regional Prizren, në shumën prej 16,817.80€. Sipas vlerësimit të gjykatës, paditësi nuk ka bazë ligjore që të njëjtit t’i kompensohet dëmi material në formën e fitimit të humbur sipas nenit 173 të LMD-së. Gjykata vlerëson se për kompensimin e dëmit kërkohet të përmbushen dy elemente themelore: dëmi të ketë bazë ligjore dhe të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit dhe pasojës. Në rastin konkret asnjë dispozitë ligjore nuk e njeh dëmin e pësuar si pasojë e mosfitimit të kontratës nga një ofertë publike. Baza ligjore për kërkimin e fitimit të humbur do të krijohej në momentin e dhënies së njoftimit për dhënien e kontratës dhe kalimit të afatit për paraqitjen e ankesës përkatësisht vërtetimit të njëjtit nga OSHP, në rast ankese, dhe mos veprimit të autoritetit kontraktues në bazë të atij njoftimi. Prandaj nuk mund të merret parasysht fitimi i cili sipas supozimit se do të mund ndodhte por vetëm ai fitim i cili në bazë të rrethanave objektive, në mënyrë të bazuar pritet të ndodhë. Kjo nënkupton se dispozita e sipërcituara ia njeh të dëmtuarit të drejtën për kompensimin e fitimit të munguar i cili do të ndodhte gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij të rregullt pas pranimit të njoftimit për tenderuesin e suksesshëm dhe njoftimin për dhënie të kontratës.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 dhe 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se mungon arsyetimi i mirëfillt ligjor se pse nuk mund të aprovohet kërkesa për fitimin e humbur edhe pse është konstatuar dhe vërtetuar si e tillë përmes ekspertizës financiare. Gjatë procedimit në këtë çështje janë nxjerrë ekspertizat si nga fusha e biokimisë ashtu edhe nga fusha e prokurimit publik të cilët kanë konstatuar se veprimet e të paditurës së dytë ishin të kundërligjshme dhe i kanë pamundësuar paditësit dhënien e kontratës nga e paditura e dytë. Përveç kësaj është konstatuar edhe lartësia e dëmit të pësuar material në formën e fitimit të humbur si rezultat i veprimit të paditurës së dytë mirëpo si e tillë kjo kërkesë është refuzuar. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë i është referua nenit gjykata vlerëson se Autoriteti Kontraktues duke iu referuar nenit 59, par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i cili përcakton se: *“4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në*

dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.” Kolegji njejtë si Dhoma e Shkallës së Parë vlerëson se në këtë rast fitimi i një kontrate publike nuk është e drejtë e garantuar por vetëm mundësi për operatorët ekonomik, andaj të njëjtëve me ligj iu mundësohet kompensimi i dëmit material real që mund t`i pësoj nga procedurat jo të rregullta të prokurimit, ndërsa, lidhur me kërkesën për fitimin e munguar si pjesë integrale e kompensimit për dëmin e pësuar sipas nenit 173 të LMD-së, mund të njihet vetëm nëse ai do të realizohej gjithsesi, sipas rrjedhjes të rregullt të gjërave, në rast se realizimi i të njëjtit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin. Andaj, për këtë arsye Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoi si të pa bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat nuk kanë gjetur mbështetje në dispozitat ligjore materiale të cilat rregullojnë këtë çështje dhe nuk kanë qenë në përputhje me provat e administruara për të vendosur ndryshe në këtë çështje administrative.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se venimi i Dhomës së Shkallës së Parë nuk përmban arsytetime konkrete dhe nuk ka bërë vlerësim të drejtë dhe të plotë të fakteve e po ashtu ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhoma e Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji i vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë të paditësit sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1076/24, me datë 10.10.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami